



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 227/6 prot.

Datë 16/02/2024

**V E N D I M**  
**Nr. 188/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16/02/2024 shqyrtoi kërkesën me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nexia AL Consulting” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E Hapur e thjeshtuar - shërbime*” me Nr. REF-93973-01-24-2024, me objekt “*Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore*” me fond limit 3,996,000 (Tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*E Hapur e thjeshtuar- shërbime*” me Nr. REF-93973-01-24-2024, me objekt “*Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore*” me fond limit 3,996,000 (Tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Nexia AL Consulting” SHPK me NIPT L82210031Q dhe me adresë Rruga “Margarita Tutulani”, Pallati “Viridario 1” Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A  
Adresa: L.17 Rr. "Dalip Peza" Durrës.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 25.01.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar- shërbime” me Nr. REF-93973-01-24-2024, me objekt “Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirëmbajtje vjetore” me fond limit 3,996,000 (Tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

II.2. Në datën 30.01.2024, operatori ekonomik “Nexia AL Consulting” ShPK, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike ka aplikuar online ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, e cila është administruar në protokoll me nr. 227/2024 prot., datë 31.01.2024 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3779, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi e më konkretisht:

*[...I. Në shtojcën 2. Lista e Çmimeve të Shërbimeve ashtu edhe ne Shtojca 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit nuk është përcaktuar një listë tabelare e shërbimeve që duhet të realizohen, afatet e realizimit me qëllim edhe të ndjekjes të zbatimit të kontratës dhe më pas të likuidimit pjesor pas realizimit të shërbimeve.*

*Për sa më sipër kërkojmë plotësimin/shtimin e tabelës me anë të së cilës të përcaktohen: i) lista e shërbimeve/furnizimeve të kërkuara; ii) sasia e shërbimeve/ furnizimeve; iii) kolona e çmimeve; iv) kolona e vlerave dhe v) kolona e afateve të realizimit.*

II. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, ne seksionin e Funkcionaliteteve të tjera që duhet të ketë programi keni kërkuar sa vijon:

1. Bazat e të dhënave, të jenë të paaksesueshme jashtë këtij sistemi
2. Hyrja në program të sigurohet me kredenciale “përdorues” dhe “Fjalëkalim”.
3. Të ofrojë një mekanizëm për administrimin e privilegjeve në mënyrë të detajuar për funksionalitete të ndryshme. Në këtë mënyrë çdo përdorues ka akses vetëm tek ambientet, modulet apo raportet që i janë përcaktuar më parë nga një përdorues administrator.
4. Të ofroje mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara.
5. Të ofroje mundësinë që një përdorues i caktuar të mund të shikojë vetëm veprimet e tij dhe jo veprimet e të tjerëve.
6. Të mundësojë regjistrimin e çdo krijimi, anulimi apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve.
7. Të mundësojë regjistrimin e datës, orës, përdoruesit dhe të IP-së së atij që ka kryer veprimin gjatë regjistrimit të auditimit.
8. Të mundësojë historikun e veprimeve, pra të mund të shihen dokumentet si kanë qenë para modifikimit.

*Backup. Të dhënat të ruhen çdo ditë nëpërmjet një procesi automatik backup*

*Konstatojme që pika 6 me sipër, në lidhje me funksionin “anulim apo modifikim dokumenti” është një funksion i kërkuar në kundërshtim me ligjin e fiskalizimit dhe specifikimet teknike të fiskalizimit dhe një software fiskalizimi i certifikuar nga AKSHI/DPT nuk duhet ta lejojë një funksion të tillë. Një dokument (në kete rast fature) e krijuar nuk duhet të modifikohet apo anulohet, por mund të krijohet një fature*

tjeter "fature korrigjuese" qe mund te korrigjohet pjeserisht apo tërësisht te paren. Për sa më sipër kërkohet heqjen e termit "anulimi apo modifikimi dokumenti" nga pika 6 me sipër dhe zvendesimin me termin "krijimin e faturave korrigjuese".

III. Në shtojcën 8 Formular i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap. I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.2 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

? ISO 9001 (për Standardin e Menaxhimit të Cilësisë) e përditësuar

? ISO 27001 (për Standardin e Sigurisë së Informacionit) e përditësuar

Këto Certifikime të kërkuara, lëshuar nga organizma certifikues, sipas datës së vlefshmërisë së tyre ose janë të vlefshme ose i ka kaluar afati i vlefshmërisë në datën e përdorimit të tyre për procedurën e prokurimit referencë, ndaj cilësimi i tyre "e përditësuar" është e pakuptimtë dhe mund të krijojë keqinterpretime. Vetë kodi i tyre dhe objekti të cilin ju keni formuluar për çdo certifikatë të listuar jep në mënyrë shteruese dhe pa ekuivok llojin e certifikatës që ju kërkoni.

Ju sjellim në vëmendje se ky rast është trajtuar dhe vlerësuar nga KPP me vendimin e tij nr. 386/2023 Për sa më sipër kërkohet heqjen e termit "e përditësuar" pas certifikatave të listuara më lart".

IV. Në shtojcën 8 Formular i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap. I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.3.3 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitet njerëzore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, inxhinieri ekonomike, shkencë kompjuterike etj.) si mëposhtë:

a) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e ofruar ose teknologjitë nga të cilat përbëhet zgjidhja

b) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e ofruar ose teknologjitë nga të cilat përbëhet zgjidhja.

c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesionist në implementimin e EEB shërbimeve nepermjet protokollit SOAP ose REST ose ekuivalent.

d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave të përdorura në zgjidhjen e ofruar

e) Të paktën 1 (një) punonjës menaxher projekti të certifikuar në nivel profesionist i diplomuar në fushën e IT

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

1. Diplomat,

2. Certifikimet perkatese dhe

3. Formularët E-SIG për periudhën e 3 muajve të fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave.

Për secilin prej punonjësve.

IV/1 Ndër të tjera është kërkuar "? të pakten 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, inxhinieri ekonomike, shkencë kompjuterike etj.)".

Në dijeninë tonë diplomë në inxhinieri ekonomike nuk ka aspak afërsi apo lidhje me fushën dhe objektin e prokurimit.

Përsa më sipër kërkojmë korigjimin e kësaj kërkesë, heqjen e kërkesës "inxhinieri ekonomike" dhe plotësimin e kësaj kërkesë me diplomime të tjera që kanë lidhje me fushën e IT.

IV/2 Në Proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime "Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim" për stafin ndër të tjera keni argumentuar si më poshtë:

Argumentim:

... Diplomimi i punonjesve ne deget informatike ose teknologji-informacioni ose elektronike, eshte kerkuar ne perputhje me objektin e prokurimit dhe termat e references pasi ky objekt prokurimi perfshin implementimin, adaptimin, testimin, migrimin, trajnimin e perdoruesve dhe instalimin e te gjitha informacioneve teknike te sistemit.

Ndërkohë në asnjë paragraf të DST apo të Termave të Referencës (ToRs) nuk gjenden kërkesa teknike për realizimin e shërbimeve të adaptimit, testimit, migrimit dhe trajnimit të përdoruesve. Në objektin e kontratës, DST dhe ToRs ju keni kërkuar "Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore" dhe shërbimet që kërkohen:

? Të përfshijë mirëmbajtjen e programit të fiskalizimit për 12 muaj.

? Afati i implementimit bashke me integrimin me Sistemin Flare Billing 5 dite nga lidhja e kontrates.

Pra, kërkohet të implementohet dhe të integrohet me sistemin Flare Billing për 5 (pesë) ditë një produkt i gatshëm që të plotësojë minimalisht kërkesat e ToRs dhe më pas të mirëmbahet ky produkt, programi i fiskalizimit.

Referuar shërbimeve të kërkuara në objektin e kontratës si dhe në ToRs, në proces-verbalin e argumentimit, arrihet në përfundimin se stafi i kërkuar është jo në përpjestim me detyrat/shërbimet e kërkuara në DST dhe ToRs.

Nga përvoja të ngjashme derimë sot kjo lloj kontrate (furnizim-shërbim) mund të realizohet nga një staf prej jo më shumë se 3 specialistë/ekspertë.

Ulja e numrit të specialistëve/ekspertëve do të ulte automatikisht koston e kësaj kontrate.

Përsa më sipër kërkojmë modifikimin e kësaj kërkesë dhe përshtatjen e saj me kuptimin tërësor të objektit të prokurimit dhe si rrjedhim përshtatjen e stafit profesional të kërkuar me detyrat reale objekt i kësaj kontrate.

IV/3 Në Proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime "Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim" për stafin e kriterit (b) keni argumentuar si më poshtë:

b) Punonjësi i kërkuar në pikën "b" vjen si nevojë per kryerjen e integrimt dhe mirembajtjes, ku do te nevojitet kryerja e zhvillimeve dhe konfigurimeve ne sistemin Flare Billing i cili eshte sistemi i faturimit qe disponon Autoriteti Kontraktor. Ky specialist garanton funksionimin e te gjithë funksionaliteteve te programit per sa i takon integrimin dhe komunikimin te sistemeve Ndërkohë referuar objektit të prokurimit "Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore", ToRs dhe shtojcës 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, në asnjë paragraf të tyre

nuk është parashikuar kryerje e zhvillimeve apo konfigurimeve në sistemin Flare Billing.

Punonjesi i kërkuar në germen (a) është i njëjte në kualifikime me punonjesin e kërkuar në germen (b). Gjithashtu për punonjësit e kërkuar në gërmën (b) dhe (c) ju keni parashikuar angazhimin njëkohësisht të tyre (brenda 5 ditëve) e tyre në kryerjen e integritit të sistemeve. Vlerësojmë se për dy sisteme të tilla do të mjaftonte vetëm një prej tyre për të siguruar integritimin e sistemeve, pikërisht ai që është edhe më pranë certifikimit për këtë shërbim, punonjësi i kërkuar sipas gërmës (c).

Për sa më sipër kërkojmë modifikimin e kësaj kërkesë, heqjen e kërkesës të punonjësit sipas gërmës (b).

IV/4 Në Proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për Kualifikim” për stafin e kriterit (e) keni argumentuar si më poshtë:

a) Punonjësi i kërkuar në pikën "e" garanton ndjekjen e te gjithë ciklit te impelmentimit te projektit, qe prej analizes dizenjimit te kerkesave, parametrizimeve, testimit dhe dokumentimin e projektit ashtu siç është cituar në specifikimet teknike në paragrafin Menaxhimi i projektit Referuar objektit të prokurimit "Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore" si dhe shtojcës 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, rezulton që është kërkuar implementimi dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit për një afat 5 (pesë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Mqs është kërkuar një produkt i gatshëm që të plotësojë minimalisht kërkesat teknike të ToRs, i cili do të implementohet dhe integrohet me sistemin e faturimit brenda afatit 5 ditor, atëhere nuk kuptohet se përse do të duhet një Menaxher Projekti i cili "... garanton ndjekjen e te gjithë ciklit te impelmentimit te projektit, qe prej analizes dizenjimit te kerkesave, parametrizimeve, testimit dhe dokumentimin e projektit ashtu siç është cituar në specifikimet teknike në paragrafin Menaxhimi i projektit..." (për sqarim, paragrafi Menaxhimi i Projektit nuk gjendet në DST/ToRs). Produkti i kërkuar duhet të jetë i gatshëm për implementim dhe ai ose i plotëson e tejkalon ose nuk i plotëson specifikimet teknike të kërkuara dhe Menaxheri i Projektit nuk kuptojmë se çfarë angazhimi do duhet të ketë për analizimin e dizenjës së kërkuar (!?), parametrizimin (!?), testimin (!?) etj, procese të cilat një produkt i gatshëm i ka tejkualuar tashmë.

Pra kërkesa që OE të ketë një Menaxher Projekti është e tepërt dhe në tejkualim të kërkesave që linden si rezultat i shërbimeve të kërkuara.

Gjithashtu kërkesa që Menaxheri i Projektit të jetë i diplomuar në fushën e IT është në kundërshtim me vendimin e KPP nr. 386/2023.

Për sa më sipër kërkojmë heqjen e kërkesës që OE duhet të ketë të angazhuar një Menaxher Projekti të certifikuar në nivel profesionisti i diplomuar në fushën e IT.

V. Në shtojcën 8 Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, Kap. I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.4.1 keni kërkuar si më poshtë:

2.4.1 Operatori ekonomik duhet te kete Autorizim Prodhuesi ose distributori per Programin e Faturim – Arketimi Flare Billing qe disponon Autoriteti kontraktues. Kjo te vertetohet nepermjet paraqitjes se Autorizimit te leshuar nga nje kompani e licencuar nga autoritetet perkatese shtetore. Kjo kompani te jete vete prodhuesi i sistemit ose te jete e autorizuar nga prodhuesi i

sistemit per te leshuar ate lloj Autorizimi.

Në Proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim”, për pikën 2.4.1 keni argumentuar si më poshtë:

Argumentim: Duke qene se AK perdor sistemin Flare Billing, per te shmangur çdo incident gjate periudhes se integritit te dy sistemeve dhe kryerjes se procesit te fiskalizimit, kerkohet qe kompania te vertetoje qe mund te punoj me sistemin Flare Billing.

Së pari kriteri është në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 36 Specifikimet Teknike, si dhe me DST, shtojca 5 Formulari i Specifikimeve Teknike, të cilët përcaktojnë qartë se:

Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët ose ekuivalent”.

Së pari, referenca për markën që ju citoni nuk është shoqëruar me termin “ose ekuivalent”.

Së dyti, në argumentimin tuaj nuk jepet një vlerësim dhe parashikim teknik shterues dhe bindës që kjo kërkesë të jetë e domosdoshme për këto shërbime/furnizime. Në argumentim ju i referoheni rastësisë, “shmangies të çdo incidenti” gjatë periudhës së integritit të dy sistemeve (që realizohet brenda 5 ditëve) dhe jo domosdoshmërisë në detyrat e parashikuara për realizimin e shërbimeve 12 mujore.

Së treti, referuar objektit të prokurimit “Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirëmbajtje vjetore”, ToRs dhe shtojcës 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, në asnjë paragraf të tyre nuk është parashikuar ndërhyrje apo kryerje e zhvillimeve/përditësimeve në sistemin Flare Billing. Gjithsesi edhe në një rast të tillë ndërhyrjeje në një sistem/program kompjuterik, autoriteti kontraktor zotëron kodin burim, me anë të të cilit çdo ekspert IT i

kualifikuar mund të ndërhyjë për të kryer ndërhyrjet apo zhvillimet/përditësimet e kërkuara.

Pra, kërkesa 2.4.1 është jo në përputhje me detyrat/objektivat e kërkuara dhe njëkohësisht e jashtëligjshme.

Për sa më sipër kërkojmë heqjen e kërkesës 2.4.1.

VI. Në shtojcën 8 Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, keni kërkuar si më poshtë:

2.4.3 Operatori Ekonomik duhet te paraqes propozimin teknik per permbushjen e specifikimeve teknike te kerkuara.

Ndërkohë kjo kërkesë nuk është shoqëruar me kujtesën që ky kriter në këtë fazë ofertimi plotësohet përmes formularit të vetëdeklarimit.

Shtojca 9 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit ndër të tjera shprehet si më poshtë: Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARAT? Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës.

Deklarata Përgjigje

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të

paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor. Po [ ] Jo [ ]

Pra, me anë të formularit të vetëdeklarimit operatori ekonomik deklaron plotësimin e specifikimeve teknike (nënkupto ofertën teknike) në fazën e ofertimit elektronik të ofertave dhe kjo kërkesë pika 2.4.3 është në tejkallim të kërkesave ligjore në këtë fazë ofertimi.

Duke e konsideruar të paqartë dhe që krijon konfuzion në momentin e dorëzimit të ofertës elektronike, kërkojmë plotësimin e këtij kriteri sipas kërkesave ligjore.

II.3. Më datë 01.02.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, operatori ekonomik “Nexia AL Consulting” ShPK ka administruar në protokoll “Formular Ankese” me nr. 227/2 prot., datë 01.02.2024, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.4. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.5. Me shkresën nr. 36/25 prot., datë 05.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 227/3 prot., datë 07.02.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Nexia AL Consulting” SHPK, ku rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur që të pranojë pjesërisht pretendimet e ankimuesit, si më poshtë vijon:

*I. Në shtojcën 2. Lista e Çmimeve të Shërbimeve ashtu edhe në Shtojca 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit nuk është përcaktuar një listë tabelare e shërbimeve që duhet të realizohen, afatet e realizimit me qëllim edhe të ndjekjes të zbatimit të kontratës dhe më pas të likuidimit pjesor pas realizimit të shërbimeve.*

Për sa më sipër kërkojmë plotësimin/shtimin e tabelës me anë të së cilës të përcaktohen: i) lista e shërbimeve/furnizimeve të kërkuara; ii) sasia e shërbimeve/ furnizimeve; iii) kolona e çmimeve; iv) kolona e vlerave dhe v) kolona e afateve të realizimit.

KSHA vëren se:

Pranohet ankesa 1 dhe me anë të shtojcës të bëhet ndryshimi si më poshtë në “Formularin e shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit”

<i>Shërbimet</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Vendi i ekzekutimit</i>	<i>Afati i ekzekutimit</i>
1	<i>Impelementim i programit të fiskalizimit dhe Integritimit me programin e faturimit</i>	<i>SHRUK Durrës</i>	<i>Brenda 3 ditëve nga lidhja e kontratës</i>
2	<i>Mirëmbajtje e programit të fiskalimit</i>	<i>SHRUK Durrës</i>	<i>12 Muaj nga data e implementimit dhe integritimit</i>

Nga sa më sipër, KSHA arsyeton se: Ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE merret në konsideratë.



III.- Në shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap. I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.2 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

? ISO 9001 (për Standardin e Menaxhimit të Cilësisë) e perditesuar

? ISO 27001 (për Standardin e Sigurisë së Informacionit) e përditësuar

Këto Certifikime të kërkuara, lëshuar nga organizma certifikues, sipas datës së vlefshmërisë së tyre ose janë të vlefshme ose i ka kaluar afati i vlefshmërisë në datën e përdorimit të tyre për procedurën e prokurimit referencë, ndaj cilësimi i tyre “e përditësuar” është e pakuptimtë dhe mund të krijojë keqinterpretime. Vetë kodi i tyre dhe objekti të cilin ju keni formuluar për çdo certifikatë të listuar jep në mënyrë shteruese dhe pa ekuivok llojin e certifikatës që ju kërkon.

Ju sjellim në vëmendje se ky rast është trajtuar dhe vlerësuar nga KPP me vendimin e tij nr. 386/2023 Për sa më sipër kërkojmë heqjen e termit “e përditësuar” pas certifikatave të listuara më lart”.

KSHA vëren se: Pranohet ankesa 3 dhe me anë të shtojcës përkatëse të bëhen ndryshimet e nevojshme me heqjen e togfjalëshit “e përditësuar”. Nga sa më sipër, KSHA arsyeton se ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE, merret në konsideratë.

VI.-Në shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap. I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.3.3 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitet njerezore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, inxhinieri ekonomike, shkencë kompjuterike etj.) si më poshtë:

f) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e ofruar ose teknologjitë nga të cilat përbëhet zgjidhja

g) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e ofruar ose teknologjitë nga të cilat përbëhet zgjidhja.

h) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesionist në implementimin e ËEB shërbimeve nepermjet protokollit SOAP ose REST ose ekuivalent.

i) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave të perdorura në zgjidhjen e ofruar

j) Të paktën 1 (një) punonjës menaxher projekti të certifikuar në nivel profesionist i diplomuar në fushën e IT

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

4. Diplomat,

5. Certifikimet perkatëse dhe

6. Formularët E-SIG për periudhën e 3 muajve të fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave.

Për secilin prej punonjësve.

IV/1 Ndër të tjera është kërkuar “? te pakten 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, inxhinieri ekonomike, shkenca kompjuterike etj.)”.

Në dijeninë tonë diplomë në inxhinieri ekonomike nuk ka aspak afërsi apo lidhje me fushën dhe objektin e prokurimit.

Për sa më sipër kërkojmë korrigjimin e kësaj kërkesë, heqjen e kërkesës ”inxhinieri ekonomike” dhe plotësimin e kësaj kërkesë me diplomime të tjera që kanë lidhje me fushën e IT.

KSHA vëren se: Për sa i përket kësaj pike të ankesës rikujtojmë se sipas vendimeve të KPP është në diskrecionin e autoritetit kontraktor kërkesat për numrin e punonjësve që mendon të arsyeshëm për realizimin e shërbimeve objekt kontrate. Më konkretisht për të shmangur keqkuptimet dhe konfuzion të operatorëve ekonomikë të interesuar bëhet ndryshimi ku togfjalëshi “inxhinieri ekonomike” zëvendësohet me “informatikë ekonomike”. Nga sa më sipër, KSHA arsyeton se ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE merret në konsideratë.

IV/3 Në Proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim” për stafin e kriterit (b) keni argumentuar si më poshtë:

b) Punonjësi i kërkuar në pikën "b" vjen si nevojë për kryerjen e integritit dhe mirembajtjes, ku do të nevojitet kryerja e zhvillimeve dhe konfigurimeve në sistemin Flare Billing i cili është sistemi i faturimit që disponon Autoriteti Kontraktor. Ky specialist garanton funksionimin e të gjithë funksionaliteteve të programit për sa i takon integritit dhe komunikimit të sistemeve Ndërkohë referuar objektit të prokurimit "Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore", ToRs dhe shtojcës 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, në asnjë paragraf të tyre nuk është parashikuar kryerja e zhvillimeve apo konfigurimeve në sistemin Flare Billing.

Punonjësi i kërkuar në germen (a) është i njëjti në kualifikime me punonjësin e kërkuar në germen (b). Gjithashtu për punonjësit e kërkuar në gërmën (b) dhe (c) ju keni parashikuar angazhimin njëkohësisht të tyre (brenda 5 ditëve) e tyre në kryerjen e integritit të sistemeve. Vlerësojmë se për dy sisteme të tilla do të mjaftonte vetëm një prej tyre për të siguruar integritin e sistemeve, pikërisht ai që është edhe më pranë certifikimit për këtë shërbim, punonjësi i kërkuar sipas gërmës (c).

Për sa më sipër kërkojmë modifikimin e kësaj kërkesë, heqjen e kërkesës të punonjësit sipas gërmës (b).

KSHA vëren se, për sa i përket kësaj pike të ankesës autoriteti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe për këtë fakt do të bëjë modifikimet e nevojshme në pikën “b” e cila do të ndryshojë si më poshtë vijon: b)Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e faturimit ekzistues ose teknologjitë nga të cilat përbëhet zgjidhja.

Kërkesa për disponimin e këtij punonjësi është e bazuar në specifikimet teknike dhe termat e referencës më konkretisht në pikën “b” dhe në pikën “i” në të cilat janë parashikuar funksionalitetet e programit të fiskalizimit. Gjithashtu sjellim në vëmendje që në këtë kontratë është objekt i saj dhe integriti i programit të fiskalizimit me programin e faturimit ekzistues e cila do të kërkojë zhvillime, konfigurime si në programin e fiskalizimit dhe gjithashtu në atë të faturimit Flare Billing.

IV/4 Në Proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime “Për Argumentimin dhe Miratimin e

*Specifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim” për stafin e kriterit (e) keni argumentuar si më poshtë:*

a) *Punonjësi i kërkuar në pikën "e" garanton ndjekjen e te gjithë ciklit te impelmentimit te projektit, qe prej analizes dizenjimit te kerkesave, parametrizimeve, testimit dhe dokumentimin e projektit ashtu siç eshte cituar ne specifikimet teknike ne paragrafin Menaxhimi i projektit Referuar objektit të prokurimit "Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore" si dhe shtojcës 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, rezulton që është kërkuar implementimi dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit për një afat 5 (pesë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Mqs është kërkuar një produkt i gatshëm që të plotësojë minimalisht kërkesat teknike të ToRs, i cili do të implementohet dhe integrohet me sistemin e faturimit brenda afatit 5 ditor, atëhere nuk kuptohet se përse do të duhet një Menaxher Projekti i cili "... garanton ndjekjen e te gjithë ciklit te impelmentimit te projektit, qe prej analizes dizenjimit te kerkesave, parametrizimeve, testimit dhe dokumentimin e projektit ashtu siç eshte cituar ne specifikimet teknike ne paragrafin Menaxhimi i projektit..." (për sqarim, paragrafi Menaxhimi i Projektit nuk gjendet në DST/ToRs). Produkti i kërkuar duhet të jetë i gatshëm për implementim dhe ai ose i plotëson e tejkalon ose nuk i plotëson specifikimet teknike të kërkuara dhe Menaxheri i Projektit nuk kuptojmë se çfarë angazhimi do duhet të ketë për analizimin e dizenjës së kërkuar (!?), parametrizimin (!?), testimin (!?) etj, procese të cilat një produkt i gatshëm i ka tejkalluar tashmë. Pra kërkesa që OE të ketë një Menaxher Projekti është e tepërt dhe në tejkallim të kërkesave që lindin si rezultat i shërbimeve të kërkuara.*

*Gjithashtu kërkesa që Menaxheri i Projektit të jetë i diplomuar në fushën e IT është në kundërshtim me vendimin e KPP nr. 386/2023.*

*Për sa më sipër kërkojmë heqjen e kërkesës që OE duhet të ketë të angazhuar një Menaxher Projekti të certifikuar në nivel profesionisti i diplomuar në fushën e IT.*

*KSHA vëren se, Për sa i përket kësaj pike ju bëjmë me dije që certifikimi i punonjësit sipas pikës "e" të parashikuar është mjaft i nevojshëm për ecurinë dhe zbatimin e objektit të kontratës konform të gjitha parashikimeve dhe afateve të përcaktuara. kërkesa për disponimin e një menaxher projekti i diplomuar në fushën e IT është totalisht i bazuar dhe konform të gjitha rekomandimeve të parashikuara nga APP dhe vendimeve unifikuese të KPP. Ju sjellim në vëmendje që diplomimi i menaxherit të projektit në fushën e IT është i lidhur ngushtësisht me objektin e kësaj kontrate që është shërbime në fushën e IT. Për këtë kërkesë AK ka hartuar dhe procesverbalin e argumentimit ku ka parashtruar të gjitha argumentimet për këtë kërkesë. Për sa cituam më lart kjo pikë e ankesës pranohet pjesërisht dhe bëhet modifikim i pikës "e" si më poshtë: e)Të paktën 1 (një) punonjës menaxher projekti të certifikuar në nivel profesionist. Edhe pse software i fiskalizimit është një produkt i gatshëm përpara se të quhet i përdorshëm nga AK, operatori ekonomik duhet që ta instalojë/aktivizojë softwarin për AK. OE duhet të që të bëjë konfigurimet e përshatshme, integrimet e kërkuara dhe të sigurohet që të gjitha këto janë bërë në rregull përpara që të bëjë dorëzimin në AK. Gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës, siç ndodh normalisht AK do të ketë komunikim me OE dhe kërkesat e ndryshme të cilat do duhet të vlerësohen nga OE për zgjidhjen e tyre. Përveç kësaj do të ketë dhe shkëmbim dokumentacioni sipas afateve të kërkuara. Menaxhimi i të gjithë këtyre aktivitetëve dhe të tjera, menaxhimin e skuadrës të OE që do të merret me kryerjen e detyrave të kësaj kontrate do të bëhen nga një menaxher projekti i certifikuar në nivel profesionist. Nga sa më sipër, KSHA arsyeton se ankesa e bërë në lidhje me*

këtë pikë nga OE, merret pjesërisht në konsideratë.

VI.- Në shtojcën 8 Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, keni kërkuar si më poshtë:

2.4.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqes propozimin teknik për përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara.

Ndërkohë kjo kërkesë nuk është shoqëruar me kujtesën që ky kriter në këtë fazë ofertimi plotësohet përmes formularit të vetëdeklarimit.

Shtojca 9 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit ndër të tjera shprehet si më poshtë: Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARAT? Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës.

Deklarata Përgjigje

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor. Po [ ] Jo [ ]

Pra, me anë të formularit të vetëdeklarimit operatori ekonomik deklaron plotësimin e specifikimeve teknike (nënkupto ofertën teknike) në fazën e ofertimit elektronik të ofertave dhe kjo kërkesë pika 2.4.3 është në tejkalim të kërkesave ligjore në këtë fazë ofertimi.

Duke e konsideruar të paqartë dhe që krijon konfuzion në momentin e dorëzimit të ofertës elektronike, kërkojmë plotësimin e këtij kriteri sipas kërkesave ligjore

KSHA vëren se për sa i përket kësaj pike të ankesës pranohet dhe AK do të vijojë me ndryshimet përkatëse duke e hequr këtë kërkesë të parashikuar në DST. Nga sa më sipër, KSHA arsyeton se ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE, merret në konsideratë.

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën në përputhje me këto pretendime të pranuar. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të marrë masa për publikimin në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, të shtojcës për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, në përputhje me pretendimin e pranuar pjesërisht.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, si dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

**Arsyeton:**

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

III.1. Në datën 25.01.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar- shërbime” me Nr. REF-93973-01-24-2024, me objekt “Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirëmbajtje vjetore” me fond limit 3,996,000 (Tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

III.1.1. Në datën 30.01.2024, operatori ekonomik “Nexia AL Consulting” ShPK, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, ka aplikuar online ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, e cila është administruar në protokoll me nr. 227/2024 prot., datë 31.01.2024 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3779, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Me shkresën nr. 36/25 prot., datë 05.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 227/3 prot., datë 07.02.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Nexia AL Consulting” SHPK, ku rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, ku ka vendosur që të pranojë pjesërisht pretendimet e ankimuesit, si më poshtë vijon:

*I. Në shtojcën 2. Lista e Çmimeve të Shërbimeve ashtu edhe ne Shtojca 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit nuk është përcaktuar një listë tabelare e shërbimeve që duhet të realizohen, afatet e realizimit me qëllim edhe të ndjekjes të zbatimit të kontratës dhe më pas të likuidimit pjesor pas realizimit të shërbimeve.*

*Për sa më sipër kërkojmë plotësimin/shtimin e tabelës me anë të së cilës të përcaktohen: i) lista e shërbimeve/furnizimeve të kërkuara; ii) sasia e shërbimeve/ furnizimeve; iii) kolona e çmimeve; iv) kolona e vlerave dhe v) kolona e afateve të realizimit.*

KSHA vëren se:

*Pranohet ankesa 1 dhe me anë të shtojcës të bëhet ndryshimi si më poshtë në “Formularin e shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit”*

<i>Shërbimet</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Vendi i ekzekutimit</i>	<i>Afati i ekzekutimit</i>
<i>1</i>	<i>Impelementim i programit të fiskalizimit dhe Integritimit me programin e faturimit</i>	<i>SHRUK Durrës</i>	<i>Brenda 3 ditëve nga lidhja e kontratës</i>
<i>2</i>	<i>Mirëmbajtje e programit të fiskalizimit</i>	<i>SHRUK Durrës</i>	<i>12 Muaj nga data e implementimit dhe integritimit</i>

*Nga sa më sipër, KSHA arsyeton se: Ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE merret në konsideratë.*

*III.- Në shtojcën 8 Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap. I. Kriteret e Veçanta të*

Kualifikimit, pika 2.3.2 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

? ISO 9001 (për Standardin e Menaxhimit të Cilësisë) e përditësuar

? ISO 27001 (për Standardin e Sigurisë së Informacionit) e përditësuar

Këto Certifikime të kërkuara, lëshuar nga organizma certifikues, sipas datës së vlefshmërisë së tyre ose janë të vlefshme ose i ka kaluar afati i vlefshmërisë në datën e përdorimit të tyre për procedurën e prokurimit referencë, ndaj cilësimi i tyre “e përditësuar” është e pakuptimtë dhe mund të krijojë keqinterpretime. Vetë kodi i tyre dhe objekti të cilin ju keni formuluar për çdo certifikatë të listuar jep në mënyrë shteruese dhe pa ekuivok llojin e certifikatës që ju kërkon.

Ju sjellim në vëmendje se ky rast është trajtuar dhe vlerësuar nga KPP me vendimin e tij nr. 386/2023 Për sa më sipër kërkojmë heqjen e termit “e përditësuar” pas certifikatave të listuara më lart”.

KSHA vëren se: Pranohet ankesa 3 dhe me anë të shtojcës përkatëse të bëhen ndryshimet e nevojshme me heqjen e togfjalëshit “e përditësuar”. Nga sa më sipër, KSHA arsyeton se ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE, merret në konsideratë.

VI.-Në shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap. I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.3.3 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerezore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, inxhinieri ekonomike, shkencë kompjuterike etj.) si më poshtë:

k) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e ofruar ose teknologjite nga të cilat përbëhet zgjidhja

l) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e ofruar ose teknologjitë nga të cilat përbëhet zgjidhja.

m) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesionist në implementimin e EEB shërbimeve nepermjet protokollit SOAP ose REST ose ekuivalent.

n) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave të përdorura në zgjidhjen e ofruar

o) Të paktën 1 (një) punonjës menaxher projekti të certifikuar në nivel profesionist i diplomuar në fushën e IT

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

7. Diplomat,

8. Certifikimet përkatëse dhe

9. Formularët E-SIG për periudhën e 3 muajve të fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave.

Për secilin prej punonjësve.

IV/1 Ndër të tjera është kërkuar “? të paktën 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, inxhinieri ekonomike, shkencë kompjuterike etj.)”.

Në dijeninë tonë diplomë në inxhinieri ekonomike nuk ka aspak afërsi apo lidhje me fushën dhe objektin e prokurimit.

Për sa më sipër kërkojmë korrigjimin e kësaj kërkesë, heqjen e kërkesës "inxhinieri ekonomike" dhe plotësimin e kësaj kërkesë me diplomime të tjera që kanë lidhje me fushën e IT.

KSHA vëren se: Për sa i përket kësaj pike të ankesës rikujtojmë se sipas vendimeve të KPP është në diskrecionin e autoritetit kontraktor kërkesat për numrin e punonjësve që mendon të arsyeshëm për realizimin e shërbimeve objekt kontrate. Më konkretisht për të shmangur keqkuptimet dhe konfuzion të operatorëve ekonomikë të interesuar bëhet ndryshimi ku togfjalëshi "inxhinieri ekonomike" zëvendësohet me "informatikë ekonomike". Nga sa më sipër, KSHA arsyeton se ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE merret në konsideratë.

IV/3 Në Proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime "Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim" për stafin e kriterit (b) keni argumentuar si më poshtë:

b) Punonjësi i kërkuar në pikën "b" vjen si nevojë për kryerjen e integritit dhe mirembajtjes, ku do të nevojitet kryerja e zhvillimeve dhe konfigurimeve në sistemin Flare Billing i cili është sistemi i faturimit që disponon Autoriteti Kontraktor. Ky specialist garanton funksionimin e të gjithë funksionaliteteve të programit për sa i takon integritit dhe komunikimit të sistemeve Ndërkohë referuar objektit të prokurimit "Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore", ToRs dhe shtojcës 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, në asnjë paragraf të tyre nuk është parashikuar kryerje e zhvillimeve apo konfigurimeve në sistemin Flare Billing.

Punonjësi i kërkuar në germen (a) është i njëjti në kualifikime me punonjësin e kërkuar në germen (b). Gjithashtu për punonjësit e kërkuar në gërmën (b) dhe (c) ju keni parashikuar angazhimin njëkohësisht të tyre (brenda 5 ditëve) e tyre në kryerjen e integritit të sistemeve. Vlerësojmë se për dy sisteme të tilla do të mjaftonte vetëm një prej tyre për të siguruar integritimin e sistemeve, pikërisht ai që është edhe më pranë certifikimit për këtë shërbim, punonjësi i kërkuar sipas gërmës (c).

Për sa më sipër kërkojmë modifikimin e kësaj kërkesë, heqjen e kërkesës të punonjësit sipas gërmës (b).

**KSHA vëren se, për sa i përket kësaj pike të ankesës autoriteti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe për këtë fakt do të bëjë modifikimet e nevojshme në pikën "b" e cila do të ndryshojë si më poshtë vijon:**  
b) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e faturimit ekzistues ose teknologjitë nga të cilat përbëhet zgjidhja.

Kërkesa për disponimin e këtij punonjësi është e bazuar në specifikimet teknike dhe termat e referencës më konkretisht në pikën "b" dhe në pikën "i" në të cilat janë parashikuar funksionalitetet e programit të fiskalizimit. Gjithashtu sjellim në vëmendje që në këtë kontratë është objekt i saj dhe integrimi i programit të fiskalizimit me programin e faturimit ekzistues e cila do të kërkojë zhvillime, konfigurime si në programin e fiskalizimit dhe gjithashtu në atë të faturimit Flare Billing.

IV/4 Në Proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime "Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim" për stafin e kriterit (e) keni argumentuar si më poshtë:

a) Punonjësi i kërkuar në pikën "e" garanton ndjekjen e te gjithë ciklit te impelmentimit te projektit, qe prej analizes dizenjimit te kerkesave, parametrizimeve, testimit dhe dokumentimin e projektit ashtu siç eshte cituar ne specifikimet teknike ne paragrafin Menaxhimi i projektit Referuar objektit të prokurimit "Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore" si dhe shtojcës 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, rezulton që është kërkuar implementimi dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit për një afat 5 (pesë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Mqs është kërkuar një produkt i gatshëm që të plotësojë minimalisht kërkesat teknike të ToRs, i cili do të implementohet dhe integrohet me sistemin e faturimit brenda afatit 5 ditor, atëhere nuk kuptohet se përse do të duhet një Menaxher Projekti i cili "... garanton ndjekjen e te gjithë ciklit te implementimit te projektit, qe prej analizes dizenjimit te kerkesave, parametrizimeve, testimit dhe dokumentimin e projektit ashtu siç eshte cituar ne specifikimet teknike ne paragrafin Menaxhimi i projektit..." (për sqarim, paragrafi Menaxhimi i Projektit nuk gjendet në DST/ToRs). Produkti i kërkuar duhet të jetë i gatshëm për implementim dhe ai ose i plotëson e tejkalon ose nuk i plotëson specifikimet teknike të kërkuara dhe Menaxheri i Projektit nuk kuptojmë se çfarë angazhimi do duhet të ketë për analizimin e dizenjios së kërkuar (!?), parametrizimin (!?), testimin (!?) etj, procese të cilat një produkt i gatshëm i ka tejkualuar tashmë.

Pra kërkesa që OE të ketë një Menaxher Projekti është e tepërt dhe në tejkualim të kërkesave që lindin si rezultat i shërbimeve të kërkuara.

Gjithashtu kërkesa që Menaxheri i Projektit të jetë i diplomuar në fushën e IT është në kundërshtim me vendimin e KPP nr. 386/2023.

Për sa më sipër kërkojmë heqjen e kërkesës që OE duhet të ketë të angazhuar një Menaxher Projekti të certifikuar në nivel profesionisti i diplomuar në fushën e IT.

KSHA vëren se, Për sa i përket kësaj pike ju bëjmë me dije që certifikimi i punonjësit sipas pikës "e" të parashikuar është mjaft i nevojshëm për ecurinë dhe zbatimin e objektit të kontratës konform të gjitha parashikimeve dhe afateve të përcaktuara. kërkesa për disponimin e një menaxher projekti i diplomuar në fushën e IT është totalisht i bazuar dhe konform të gjitha rekomandimeve të parashikuara nga APP dhe vendimeve unifikuese të KPP. Ju sjellim në vëmendje që diplomimi i menaxherit të projektit në fushën e IT është i lidhur ngushtësisht me objektin e kësaj kontrate që është shërbime në fushën e IT. Për këtë kërkesë AK ka hartuar dhe procesverbalin e argumentimit ku ka parashtruar të gjitha argumentimet për këtë kërkesë. Për sa cituam më lart kjo pikë e ankesës pranohet pjesërisht dhe bëhet modifikim i pikës "e" si më poshtë:  
e)Të paktën 1 (një) punonjës menaxher projekti të certifikuar në nivel profesionist. Edhe pse software i fiskalizimit është një produkt i gatshëm përpara se të quhet i përdorshëm nga AK, operatori ekonomik duhet që ta instalojë/aktivizojë softwarin për AK. OE duhet të që të bëjë konfigurimet e përshtatshme, integrimet e kërkuara dhe të sigurohet që të gjitha këto janë bërë në rregull përpara që të bëjë dorëzimin në AK. Gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës, siç ndodh normalisht AK do të ketë komunikim me OE dhe kërkesat e ndryshme të cilat do duhet të vlerësohen nga OE për zgjidhjen e tyre. Përveç kësaj do të ketë dhe shkëmbim dokumentacioni sipas afateve të kërkuara. Menaxhimi i të gjithë këtyre aktiviteteve dhe të tjera, menaxhimin e skuadrës të OE që do të merret me kryerjen e detyrave të kësaj kontrate do të bëhen nga një menaxher projekti i certifikuar në nivel profesionist. Nga sa më sipër, KSHA arsyeton se ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE, merret pjesërisht në konsideratë.



VI.- Në shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, keni kërkuar si më poshtë:

2.4.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqes propozimin teknik për përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara.

Ndërkohë kjo kërkesë nuk është shoqëruar me kujtesën që ky kriter në këtë fazë ofertimi plotësohet përmes formularit të vetëdeklarimit.

Shtojca 9 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit ndër të tjera shprehet si më poshtë: Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARAT? Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës.

Deklarata Përgjigje

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimin të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor. Po [ ] Jo [ ]

Pra, me anë të formularit të vetëdeklarimit operatori ekonomik deklaron plotësimin e specifikimeve teknike (nënkupto ofertën teknike) në fazën e ofertimit elektronik të ofertave dhe kjo kërkesë pika

2.4.3 është në tejkallim të kërkesave ligjore në këtë fazë ofertimi.

Duke e konsideruar të paqartë dhe që krijon konfuzion në momentin e dorëzimit të ofertës elektronike, kërkojmë plotësimin e këtij kriteri sipas kërkesave ligjore

KSHA vëren se për sa i përket kësaj pike të ankesës pranohet dhe AK do të vijojë me ndryshimet përkatëse duke e hequr këtë kërkesë të parashikuar në DST. **Nga sa më sipër, KSHA arsyeton se ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE, merret në konsideratë.**

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij

ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën në përputhje me këto pretendime të pranuar. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të marrë masa për publikimin në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, të shtojcës për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, në përputhje me pretendimin e pranuar pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar i cili parashikon se: “Nëse operatorët ekonomikë të interesuar, nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të kësaj pike, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë lidhur me ankesën për këtë procedurë prokurimi”, si dhe Urdhrit nr. 03, datë 11.01.2022 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, vendosi të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit të sipërcituar si dhe të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Nexia AL Consulting” SHPK “Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, ne seksionin e Funksionaliteve të tjera që duhet të ketë programi keni kërkuar sa vijon:

1. Bazat e të dhënave, të jenë të paaksesueshme jashtë këtij sistemi.
2. Hyrja në program të sigurohet me kredenciale “përdorues” dhe “Fjalëkalim”.
3. Të ofrojë një mekanizëm për administrimin e privilegjeve në mënyrë të detajuar për funksionalitete të ndryshme. Në këtë mënyrë çdo përdorues ka akses vetëm tek ambientet, modulet apo raportet që i janë përcaktuar më parë nga një përdorues administrator.
4. Të ofroje mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara.
5. Të ofroje mundësinë që një përdorues i caktuar të mund të shikojë vetëm veprimet e tij dhe jo veprimet e të tjerëve.
6. Të mundësojë regjistrimin e çdo krijimi, anulimi apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve.

7. Të mundësoje regjistrimin e datës, orës, përdoruesit dhe të IP-së së atij që ka kryer veprimin gjatë regjistrimit të auditimit.
8. Të mundësoje historikun e veprimeve, pra të mund të shihen dokumentet si kanë qenë para modifikimit.

*Backup. Të dhënat të ruhen çdo ditë nëpërmjet një procesi automatik backup*

*Konstatohet që pika 6 me sipër, në lidhje me funksionin "anulim apo modifikim dokumenti" është një funksion i kërkuar në kundërshtim me ligjin e fiskalizimit dhe specifikimet teknike të fiskalizimit dhe një software fiskalizimi i certifikuar nga AKSHI/DPT nuk duhet ta lejojë një funksion të tillë. Një dokument (në këtë rast fature) e krijuar nuk duhet të modifikohet apo anulohet, por mund të krijohet një faturë tjetër "faturë korigjuese" që mund të korigjojë pjesërisht apo tërësisht të parën. Për sa më sipër kërkohet heqjen e termit "anulimi apo modifikimi dokumenti" nga pika 6 me sipër dhe zvendesimin me termin "krijimin e faturave korigjuese", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.2.1. Në shtojcën 5 "Formulari i specifikimeve teknike" të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

### **Shtojca 5.**

*[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]*

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

*Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.*

*SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

*Skicimet, parametrat teknik etj:*

*Specifikimi i Materialeve:*

*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:*

*Funksionalitetet të tjera që duhet të ketë programi:*

1. Bazat e të dhënave, të jenë të paaksesueshme jashtë këtij sistemi
2. Hyrja në program të sigurohet me kredenciale "përdorues" dhe "Fjalëkalim".
3. Të ofrojë një mekanizëm për administrimin e privilegjeve në mënyrë të detajuar për funksionalitete të ndryshme. Në këtë mënyrë çdo përdorues ka akses vetëm tek ambientet, modulet apo raportet që i janë përcaktuar më parë nga një përdorues administrator.

4. Të ofroje mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara.
5. Të ofroje mundësinë që një përdorues i caktuar të mund të shikojë vetëm veprimet e tij dhe jo veprimet e të tjerëve.
6. Të mundesojë regjistrimin e çdo krijimi, anulimi apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve.
7. Të mundesojë regjistrimin e datës, orës, përdoruesit dhe të IP-së së atij që ka kryer veprimin gjatë regjistrimit të auditimit.
8. Të mundesojë historikun e veprimeve, pra të mund të shihen dokumentet si kanë qenë para modifikimit.

*Backup. Të dhënat të ruhen çdo ditë nëpërmjet një procesi automatik backup.*

Në Shtojcën 7 “Termat e referencës” të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar modulet dhe funksionalitetet përkatëse të sistemit të fiskalizimit, si më poshtë:

### **Shtojca 7**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### **TERMAT E REFERENCES**

*Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:*

#### **I. Hyrje**

*Shoqëria rajonale Ujësjetles Kanalizime Durres pritet të gjenerojë rreth 132000 abonente. Bazuar në Ligjin Nr. 87/2019 Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Udhezim nr. 16 date 03.04.2020 Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Vendim Nr. 239 datë 20.03.2020 Për Kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software për procedurë e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedura për kriteret e regjistrimin e prodhuesve e të mirëmbajtesve të zgjidhjeve software-ike, Shoqëria rajonale UK Durres kërkon implementimin e një programi fiskalizimi me integrim me programin e Faturim – Arketimi Flare Billing për të fiskalizuar faturat e abonentëve.*

#### **II. Programi i fiskalizimit**

*Funksionalitetet që duhet të ketë programi:*

- a) Të jete i afte të fiskalizojë të gjithë faturat e abonentëve çdo muaj njëherësh
- b) Të jetë i integruar me sistemin e faturimit Flare Billing. Faturat për të gjithë abonentët të merren automatikisht nga sistemi I faturimit Flare Billing dhe të fiskalizohen.
- c) Sistemi i fiskalizimit të dërgojë sistemit të faturimit Flare Billing të gjithë informacionin e nevojshëm mbi fiskalizimin e faturave.
- d) Faturat për veprimet të cilat nuk përfshihen në sistemin e Flare Billing si psh lidhje të reja, ndryshim emri etj. të ketë mundësi të regjistrohen manualisht.
- e) Të jetë i integruar me sistemin e Flare billing për të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për arketimet e faturave.
- f) Të gjenerojë raporte dhe informacion mbi faturat të cilat janë fiskalizuar ose jo.
- g) Të jete i bazuar në ueb

- h) Të përfshijë mirëmbajtjen e programit të fiskalizimit për 12 muaj.
- i) Afati i implementimit bashke me integrimin me Sistemin Flare Billing 5 dite nga lidhja e kontrates.

Sipas vendimit nr:239 dt. 20/03/2020 bazuar në LIGJIN Nr. 87/2019 PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT;

Operatori Ekonomik duhet të ketë zgjidhjen e certifikuar të software-it në formën e një aplikacioni individual, ose një sistemi kompjuterik të integruar, ose një aplikacion Cloud, i cili mundëson:

- a) krijimin e një fature, një fature shoqëruese dhe vendosjen e të gjithë elementeve të nevojshëm;
- b) vlefshmërinë e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese;
- c) dërgimin e sigurt të të dhënave në sistemin qendror, duke përdorur certifikatën elektronike;
- d) lëshimin dhe pranimin e faturave elektronike;
- e) transmetimin automatik të të dhënave në administratën tatimore dhe marrjen e mesazhit konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të secilës faturë individuale ose fature shoqëruese;
- f) ruajtjen e të dhënave të faturave ose të faturave shoqëruese;
- g) gjenerimin e numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF) dhe numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH);
- h) gjenerimin e kodit QR;
- i) printimin e faturës ose thjesht kodit QR, në situata të përcaktuara në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”;
- j) sigurojnë shkëmbimin e të dhënave në kohë reale dhe me autentifikim të sigurt të pajisjeve fiskale ekzistuese ose sistemit të fiskalizimit;

sipas **LIGJ Nr. 2/2017 PËR SIGURINË KIBERNETIKE**

Funksionalitetet të tjera që duhet të ketë programi:

1. Bazat e të dhënave, të jenë të paaksesueshme jashtë këtij sistemi
2. Hyrja në program të sigurohet me kredenciale “përdorues” dhe “Fjalëkalim”.
3. Të ofrojë një mekanizëm për administrimin e privilegjeve në mënyrë të detajuar për funksionalitete të ndryshme. Në këtë mënyrë çdo përdorues ka akses vetëm tek ambientet, modulet apo raportet që i janë përcaktuar më parë nga një përdorues administrator.
4. Të ofroje mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara.
5. Të ofroje mundësinë që një përdorues i caktuar të mund të shikojë vetëm veprimet e tij dhe jo veprimet e të tjerëve.
6. Të mundesojë regjistrimin e çdo krijimi, anulimi apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve.
7. Të mundesoje regjistrimin e datës, orës, përdoruesit dhe të IP-së së atij që ka kryer veprimin gjatë regjistrimit të auditimit.
8. Të mundesoje historikun e veprimeve, pra të mund të shihen dokumentet si kanë qenë para modifikimit.

9. Backup. Të dhënat të ruhen çdo ditë nëpërmjet një procesi automatik backup.

Shpërndarja: SHRUKD

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: SHRUKD

III.2.2. Në nenin 2 ‘Qëllimi’ të ligjit 162/2020 ‘Për Prokurimin Publik’, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm

*në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

Në nenin 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat shërbimeve” pika 2 dhe 6, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

III.2.3. Në pikën 3, të nenit 9 “Të dhënat e përgjithshme të faturës” të ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” parashikohet se: *“3. Çdo dokument në letër ose formë elektronike, që ndryshon faturën origjinale dhe që i referohet në mënyrë specifike e të qartë kësaj fature, konsiderohet si faturë dhe duhet të përmbajë të gjitha elementet, në përputhje me këtë ligj, si dhe referencën të fatura origjinale”.*

Në nenin 32 “Fiskalizimi i faturave korigjuese/saktësuese” të ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” parashikohet se: *“1. Të gjitha detyrimet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji për lëshimin e faturave dhe procedurën e fiskalizimit zbatohen, sipas nevojës, edhe për lëshimin e faturave korigjuese/saktësuese, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.*

*2. Fatura korigjuese/saktësuese duhet të përmbajë një referencë të fatura origjinale, që korigjohet.*

Në nenin 35 “Fiskalizimi i faturave korigjuese/saktësuese” të Udhëzimit Nr. 16, datë 03.04.2020, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” parashikohet se: *“1. Nëse tatimpaguesit shitës do t'i duhet të anulojë faturën e lëshuar, sepse blerësi nuk e ka pranuar atë (për shembull nëse ka disa gabime në faturë, ose nëse blerësi ka kthyer disa artikuj tek shitësi, ose nëse ai nuk kryen transaksionin etj.), tatimpaguesi që ka lëshuar faturën nuk mund ta fshijë atë nga libri i shitjeve ose të bëjë një anulim në sistemin e tij elektronik, por duhet të lëshojë një faturë korigjuese, notë debiti ose notë krediti, sipas akteve ligjore dhe nënligjore për TVSH-në dhe ta fiskalizojë atë.*

*2. Fatura korigjuese duhet të përmbajë të dhëna referencë për faturën që po korigjohet, pra NSLF e faturës që po korigjohet dhe të gjithë elementët e tjerë të faturës sipas Ligjit. Fatura korigjuese duhet të fiskalizohet pas verifikimit nga sistemi i informacionit i administratës tatimore qendrore. Nëse verifikimi ka qenë i suksesshëm, do të marrë një NIVF (numri identifikues i veçantë i faturës).*

*6. Në rastet kur tatimpaguesi duhet të ndryshojë elemente të tjera të faturës të cilat janë të pasakta (për shembull NIPT-i i blerësit, mënyra e pagesës etj.), së pari duhet të lëshojë një faturë korigjuese me të*

*gjithë elementët e njëjtë si në faturën origjinale (përveç datës së lëshimit dhe numrit të faturës, të cilat janë elementet që lidhen me vetë faturën korrigjuese) dhe e gjithë shuma duhet të jetë negative. Pas kësaj duhet të lëshohet një faturë e re me të dhëna të sakta dhe duke iu referuar NSLF-së së faturës së parë të lëshuar (të origjinalit dhe jo të faturës korrigjuese).*

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.2.5. Në lidhje me pretendimin e ankimuesit, ku kërkon heqjen e termit "anulim" apo "modifikim" të cituar në pikën 6 të specifikimeve teknike (shtojca 5 e dokumenteve të tenderit), në të cilin është kërkuar: "Të mundësojë regjistrimin e çdo krijimi, anulimi apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve", Komisioni sqaron, se referuar ligjit nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", janë parashikuar rregulla, kritere, detyrime, afate dhe procedura, që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit dhe prodhuesit e mirëmbajtësit e zgjidhjeve software-ike, lidhur me lëshimin e faturës, faturën shoqëruese dhe faturën elektronike, përmbajtjen e faturave, regjistrimin e të dhënave dhe procedurën e fiskalizimit të lëshimit të faturave, marrjen e informacionit të pagesave, certifikimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji. Gjithashtu, Udhëzimi Nr. 16 datë 03.04.2020 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për lëshimin e faturës dhe zbatimin e procedurës së fiskalizimit, në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 87/2019, datë 18.12.2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit". Për sa më sipër cituar, ligji sektorial ka parashikuar, që në rast anulimi apo saktësimi të elementëve të faturës, nga ana e përdoruesit të sistemit të software-it, (tatimpaguesi) që ka lëshuar faturën, nuk mund ta fshijë atë nga libri i shitjeve ose të bëjë një anulim në sistemin e tij elektronik, por lëshon një faturë korrigjuese, notë debiti ose notë krediti, sipas akteve ligjore dhe nënligjore për TVSH-në dhe e fiskalizon atë. Në këtë kuptim, pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht dhe autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri duke e hartuar atë në kuptim të ligjit sektorial të sipërcituar.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit "Nexia AL Consulting" SHPK, qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Nexia AL Consulting" SHPK "IV/2 Në Proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime "Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve



*Teknike dhe Kriterete për Kualifikim” për stafin ndër të tjera keni argumentuar si më poshtë:*

*Argumentim:*

*... Diplomimi i punonjesve ne deget informatike ose teknologji-informacioni ose elektronike, eshte kerkuar ne perputhje me objektin e prokurimit dhe termat e references pasi ky objekt prokurimi perfshin implementimin, adaptimin, testimin, migrimin, trajnimin e perdoruesve dhe instalimin e te gjitha informacioneve teknike te sistemit.*

*Ndërkohë në asnjë paragraf të DST apo të Termave të Referencës (ToRs) nuk gjenden kërkesa teknike për realizimin e shërbimeve të adaptimit, testimit, migrimit dhe trajnimit të përdoruesve. Në objektin e kontratës, DST dhe ToRs ju keni kërkuar “Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirëmbajtje vjetore” dhe shërbimet që kërkohen:*

*? Të përfshijë mirëmbajtjen e programit të fiskalizimit për 12 muaj.*

*? Afati i implementimit bashke me integrimin me Sistemin Flare Billing 5 dite nga lidhja e kontrates.*

*Pra, kërkohet të implementohet dhe të integrohet me sistemin Flare Billing për 5 (pesë) ditë një produkt i gatshëm që të plotësojë minimalisht kërkesat e ToRs dhe më pas të mirëmbahet ky produkt, programi i fiskalizimit.*

*Referuar shërbimeve të kërkuara në objektin e kontratës si dhe në ToRs, në proces-verbalin e argumentimit, arrihet në përfundimin se stafi i kërkuar është jo në përpjestim me detyrat/shërbimet e kërkuara në DST dhe ToRs.*

*Nga përvoja të ngjashme derimë sot kjo lloj kontrate (furnizim-shërbim) mund të realizohet nga një staf prej jo më shumë se 3 specialistë/ekspertë.*

*Ulja e numrit të specialistëve/ekspertëve do të ulte automatikisht koston e kësaj kontrate.*

*Për sa më sipër kërkojmë modifikimin e kësaj kërkesë dhe përshtatjen e saj me kuptimin tërësor të objektit të prokurimit dhe si rrjedhim përshtatjen e stafit profesional të kërkuar me detyrat reale objekt i kësaj kontrate., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.3.1. Në shtojcën 8, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitet njerezore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike te projektit, operatori ekonomik duhet te kete te pakten 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT( inxhinieri informatike, inxhinieri ekonomike, shkenca kompjuterike etj.) si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti ne zgjidhjen e ofruar ose teknologjite nga të cilat përbëhet zgjidhja
- b) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e ofruar ose teknologjite nga të cilat përbëhet zgjidhja.
- c) Të paktën 1 (një) punonjes te certifikuar ne nivel profesionist ne implementimin e WEB sherbimive nepermjet protokollit SOAP ose REST ose ekuivalent.
- d) Të paktën 1 (një) punonjes te certifikuar per administrimin e bazes se te dhenave te perdorura ne zgjidhjen e ofruar
- e) Të paktën 1 (një) punonjes menaxher projekti te certifikuar ne nivel profesionist i diplomuar ne fushen e IT

*Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:*

1. *Diplomat,*
  2. *Certifikimet perkatese dhe*
  3. *Formularët E-SIG për periudhen e 3 muajve te fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave.*
- Për secilin prej punonjësve.*

III.3.2. Nga shqyrtimi i procesverbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin Elektronik të Prokurimit konstatohet, se autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues dhe konkretisht të pikës 2.3.3, si më poshtë:

**Argumentim:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b dhe 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Qe te sigurohet aftesia per implementimin e kerkesave per ndryshim, zgjidhja e incidenteve dhe problemeve, zgjerimi i funksionaliteteve, etj, kerkohet qe OE duhet te kete ne stafin e propozuar me njohuri/aftesi te nevojshme te certifikuara nga prodhuesi i teknologjive baze te sistemit*

*Per realizimin e ketij sherbimi kerkohet qe ne secilen nga fushat kryesore te projektit, operatori ekonomik te perdori personel teknik te mjaftueshem dhe te kualifikuar. Fushat e mesiperme te ekspertizës si dhe numri i personelit te certifikuar, jane kryer ne baze te komponenteve te projektit si dhe te mases se angazhimit te specialisteve. Diplomimi i punonjesve ne degët **informatike ose teknologji-informacioni ose elektronike, eshte kerkuar ne perputhje me objektin e prokurimit dhe termat e references pasi ky objekt prokurimi perfshin implementimin, adaptimin, testimin, migrimin, trajnimin e perdoruesve dhe instalimin e te gjitha informacioneve teknike te sistemit.***

- a) *Punonjësi i kërkuar në pikën ‘a’ vjen si nevojë për garantimin e aftesise profesionale për implementimin e zgjidhjes për fiskalizim, zgjidhjen e incidenteve , problemeve dhe garantimin e implementimit e te gjithë specifikimeve te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor. Ky specialist garanton funksionimin e te gjithë funksionaliteteve te programit për sa i takon implementimit*
- b) *Punonjësi i kërkuar në pikën ‘b’ vjen si nevojë për kryerjen e integritit dhe mirembajtjes, ku do te nevojitet kryerja e zhvillimeve dhe konfigurimeve ne sistemin Flare Billing i cili eshte sistemi i faturimit qe disponon Autoriteti Kontraktor. Ky specialist garanton funksionimin e te gjithë funksionaliteteve te programit për sa i takon integritit dhe komunikimit te sistemeve*
- c) *Punonjësi i kërkuar në pikën ‘c’ garanton integritin nepermjet protokolleve te siperpermendura ashtu siç eshte cituar ne specifikimet teknike ne paragrafin integriti dhe komunikimi*
- d) *Punonjësi i kërkuar në pikën ‘d’ garanton mirembajtjen, optimizimin, shmangien e nderhyrjes ose manipulimit te databazes*
- e) *Punonjësi i kërkuar në pikën ‘e’ garanton ndjekjen e te gjithë ciklit te impelmentimit te projektit, qe prej analizes dizenjimit te kerkesave, parametrizimeve , testimit dhe dokumentimin e projektit ashtu siç eshte cituar ne specifikimet teknike ne paragrafin Menaxhimi i projektit*

III.3.3. Në shtojcën e datës 30.01.2024, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

#### **ISHTE**

##### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

*2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitet njerezore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT( inxhinieri informatike, inxhinieri ekonomike, shkenca kompjuterike etj.) si më poshtë:*

- f) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e ofruar ose teknologjite nga të cilat përbëhet zgjidhja*
- g) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e ofruar ose teknologjite nga të cilat përbëhet zgjidhja.*
- h) Të paktën 1 (një) punonjes të certifikuar në nivel profesionist në implementimin e WEB shërbimeve nepermjet protokollit SOAP ose REST ose ekuivalent.*
- i) Të paktën 1 (një) punonjes të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave të përdorura në zgjidhjen e ofruar*
- j) Të paktën 1 (një) punonjes menaxher projekti të certifikuar në nivel profesionist i diplomuar në fushën e IT*

*Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:*

4. Diplomat,

5. Certifikimet perkatese dhe

6. Formularët E-SIG për periudhën e 3 muajve të fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave.

*Për secilin prej punonjësve.*

#### **BËHET**

##### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

*2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitet njerezore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT( inxhinieri informatike, inxhinieri ekonomike, shkenca kompjuterike etj.) si më poshtë:*

- a) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e ofruar ose teknologjite nga të cilat përbëhet zgjidhja*
- b) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e ofruar ose teknologjite nga të cilat përbëhet zgjidhja.*
- c) Të paktën 1 (një) punonjes të certifikuar në nivel profesionist në implementimin e WEB shërbimeve nepermjet protokollit SOAP ose REST ose ekuivalent.*
- d) Të paktën 1 (një) punonjes të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave të përdorura në zgjidhjen e ofruar*
- e) Të paktën 1 (një) punonjes menaxher projekti të certifikuar në nivel profesionist i diplomuar në fushën e IT*

*Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë, për secilin prej punonjësve, duhet të paraqesin :*

- 1. Diplomat,*
- 2. Certifikimet perkatese dhe*
- 3. Formularët E-SIG për periudhen e 3 muajve te fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave. Shënim: Një punonjës mund të disponojë edhe më shumë se një certifikatë.*

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

*“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari do të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

III.3.4. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “Nexia AL Consulting” ShPK, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes nr. 36/25 prot., datë 05.02.2024, drejtuar ankimuesit, ka argumentuar si në vijim: *“Për sa i përket kësaj pike të ankesës, ritheksojmë që sipas LPP, rregullave të prokurimit publik dhe vendimeve unifikuese të KPP, është në diskrecionin e autoritetit kontraktor vendosja e kërkesave specifike për punonjësit të cilët sipas analizës së kryer nga grupi i punës është i nevojshëm për realizimin në afate dhe në mënyrë të plotë pa krijuar problematika të objektit të kontratës. Diplomimi i punonjësve sipas përcaktimeve në këtë kriter nuk është kufizues pasi autoriteti kontraktor ka cituar që diplomimi mund të jetë në një nga degët e parashikuara ose degë të tjera që kanë lidhje me këtë lloj shërbimi të kërkuar dhe rrjedhimisht ky kriter është në zbatim të të gjithë dispozitave ligjore. Siç mund të konstatohet lehtësisht në këtë kontratë kemi të bëjmë me implementimin e një software dhe integrimin e tij me sistemin e faturimit që AK ka në përdorim. Gjithashtu është përfshirë dhe mirëmbajtja për 12 muaj. Referuar objektit të kësaj kontrate kërkesat për diplomim të punonjësve në një nga degët e parashikuara ose të tjera të lidhura me këtë objekt është legjitime dhe për sa më sipër cituam kjo pikë e ankesës nuk qëndron. Në mbështetje të këtij kriteri AK ka hartuar shtojcë për argumentimet sipas parashikimeve ligjore dhe aty gjendet e plotë argumentimi për çdo kërkesë të veçantë. Nga sa më sipër KSHA arsyeton se ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE nuk merret në konsideratë”.*

III.3.5 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- e) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- f) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- g) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- h) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

4. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

5. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.3.6. Në nenin 41, pika 2 dhe 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “2. Kërkesat

*e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*4. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;*

*d) në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.*

III.3.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi dhe konkretisht modifikimin e kërkesës që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën 5 (pesë) punonjës të certifikuar si “Ekspert të Çertifikuar” në zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjes së ofruar, vërtetuar ky fakt me paraqitjen e këtyre certifikatave, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret, që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Në rastin konkret, Komisioni konstaton, se kërkesa e entit prokurues që operatori ekonomik ofertues të disponojë në stafin e tij persona që kanë aftësinë profesionale për zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjes/funksioneve të kërkuara në specifikimet teknike/termat e referencës, është një kërkesë e cila është në përputhje me objektin e prokurimit, ndërsa kërkesa që këta punonjës të jenë të paktën 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, shkenca kompjuterike, etj), është një kërkesë e nevojshme dhe në përputhje me objektin e prokurimit, pasi zhvillimi i sistemeve bëhet nga persona, të cilët kanë arsimin e duhur dhe formimin profesional, për të zhvilluar këto sisteme

në platforma të caktuara në varësi të kërkesës së autoritetit kontraktor, prandaj Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor ka argumentuar në mënyrë shteruese në procesverbalin e argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve kualifikuese, të përcaktuar pikën 2.3.3 të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit, duke përcaktuar për stafin teknik formimin profesional përkatës që duhet të kenë këta punonjës për të zhvilluar dhe mirëmbajtur këtë sistem sipas specifikimeve teknike/termat e referencës.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Nexia AL Consulting” SHPK “Në shtojcën 8 Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, Kap. I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.4.1 keni kërkuar si më poshtë:

*2.4.1 Operatori ekonomik duhet të ketë Autorizim Prodhuesi ose distributori për Programin e Faturimit – Arketimi Flare Billing që disponon Autoriteti kontraktues. Kjo të vertetohet nepermjet paraqitjes së Autorizimit të leshuar nga një kompani e licencuar nga autoritetet perkatese shtetërore. Kjo kompani të jete vete prodhuesi i sistemit ose të jete e autorizuar nga prodhuesi i sistemit për të leshuar atë lloj Autorizimi.*

*Në Proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriterëve për Kualifikim”, për pikën 2.4.1 keni argumentuar si më poshtë:*

*Argumentim: Duke qene se AK perdor sistemin Flare Billing, për të shmangur çdo incident gjatë periudhës së integritimit të dy sistemeve dhe kryerjes së procesit të fiskalizimit, kerkohet që kompania të vertetoje që mund të punoj me sistemin Flare Billing.*

*Së pari kriteri është në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 36 Specifikimet Teknike, si dhe me DST, shtojca 5 Formulari i Specifikimeve Teknike, të cilët përcaktojnë qartë se:*

*Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët ose ekuivalent”.*

*Së pari, referenca për markën që ju citoni nuk është shoqëruar me termin “ose ekuivalent”.*

*Së dyti, në argumentimin tuaj nuk jepet një vlerësim dhe parashikim teknik shterues dhe bindës që kjo kërkesë të jetë e domosdoshme për këto shërbime/furnizime. Në argumentim ju i referoheni rastësisë, “shmangies të çdo incidenti” gjatë periudhës së integritimit të dy sistemeve (që realizohet brenda 5 ditëve) dhe jo domosdoshmërisë në detyrat e parashikuara për realizimin e shërbimeve 12 mujore.*

*Së treti, referuar objektit të prokurimit “Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore”, ToRs dhe shtojcës 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, në asnjë paragraf të tyre nuk është parashikuar ndërhyrje apo kryerje e zhvillimeve/përditësimeve në sistemin Flare Billing. Gjithsesi edhe në një rast të tillë ndërhyrjeje në një sistem/program kompjuterik, autoriteti kontraktor zotëron kodin burim, me anë të të cilit çdo ekspert IT i*

*kualifikuar mund të ndërhyjë për të kryer ndërhyrjet apo zhvillimet/përditësimet e kërkuara.*

Pra, kërkesa 2.4.1 është jo në përputhje me detyrat/objektivat e kërkuara dhe njëkohësisht e jashtëligjshme.

Për sa më sipër kërkojmë heqjen e kërkesës 2.4.1., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në pikën 4.1 “Lloji i procedurës”, të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin e kontratës objekt-prokurimi, si më poshtë: Seksioni 4: Procedura 4.1 Lloji i procedurës: Procedurë e hapur e thjeshtuar – Shërbime.

III.4.2. Në shtojcën 8 “Kriteret për kualifikim” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

#### **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1 Operatori ekonomik duhet të ketë Autorizim Prodhuesi ose distributori për Programin e Faturim – Arketimi Flare Billing që disponon Autoriteti kontraktues. Kjo të vertetohet nepermjet paraqitjes së Autorizimit të leshuar nga nje kompani e licencuar nga autoritetet perkatese shteterore. Kjo kompani te jete vete prodhuesi i sistemit ose te jete e autorizuar nga prodhuesi i sistemit per te leshuar ate lloj Autorizimi.**

III.4.3. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

#### **Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

*Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.*

*SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

*Skicimet, parametrat teknik etj:*

*Specifikimi i Materialeve:*

*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:*

*Funksionalitetet të tjera që duhet të ketë programi:*

9. Bazat e të dhënave, të jenë të paaksesueshme jashtë këtij sistemi

10. Hyrja në program të sigurohet me kredenciale “përdorues” dhe “Fjalëkalim”.



11. Të ofrojë një mekanizëm për administrimin e privilegjeve në mënyrë të detajuar për funksionalitete të ndryshme. Në këtë mënyrë çdo përdorues ka akses vetëm tek ambientet, modulet apo raportet që i janë përcaktuar më parë nga një përdorues administrator.
12. Të ofroje mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara.
13. Të ofroje mundësinë që një përdorues i caktuar të mund të shikojë vetëm veprimet e tij dhe jo veprimet e të tjerëve.
14. Të mundësojë regjistrimin e çdo krijimi, anulimi apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve.
15. Të mundësojë regjistrimin e datës, orës, përdoruesit dhe të IP-së së atij që ka kryer veprimin gjatë regjistrimit të auditimit.
16. Të mundësojë historikun e veprimeve, pra të mund të shihen dokumentet si kanë qenë para modifikimit.

*Backup. Të dhënat të ruhen çdo ditë nëpërmjet një procesi automatik backup.*

Në Shtojcën 7 “Termat e referencës” të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar modulet dhe funksionalitetet përkatëse të sistemit të fiskalizimit, si më poshtë:

#### **Shtojca 7**

*( Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

#### **TERMAT E REFERENCES**

*Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:*

#### **III. Hyrje**

*Shoqëria rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durres pritet të gjenerojë rreth 132000 abonente. Bazuar në Ligjin Nr. 87/2019 Për faturen dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Udhezim nr. 16 date 03.04.2020 Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Vendim Nr. 239 datë 20.03.2020 Për Kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software për procedurë e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedura për kriteret e regjistrimit e prodhuesve e të mirëmbajtësve të zgjidhjeve software-ike, Shoqëria rajonale UK Durres kërkon implementimin e një programi fiskalizimi me integrim me programin e Faturim – Arketimi Flare Billing për të fiskalizuar faturat e abonentëve.*

#### **IV. Programi i fiskalizimit**

*Funksionalitetet që duhet të ketë programi:*

- j) Të jete i afte të fiskalizoje të gjithë faturat e abonentëve cdo muaj njëherësh*
- k) Të jetë i integruar me sistemin e faturimit Flare Billing. Faturat për të gjithë abonentët të merren automatikisht nga sistemi I faturimit Flare Billing dhe të fiskalizohen.*
- l) Sistemi i fiskalizimit të dërgojë sistemit të faturimit Flare Billing të gjithë informacionin e nevojshëm mbi fiskalizimin e faturave.*
- m) Faturat për veprimet të cilat nuk përfshihen në sistemin e Flare Billing si p.sh. lidhje të reja, ndryshim emri etj. të ketë mundësi të regjistrohen manualisht.*

- n) Të jetë i integruar me sistemin e Flare billing për të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për arketimet e faturave.
- o) Të gjenerojë raporte dhe informacion mbi faturat të cilat janë fiskalizuar ose jo.
- p) Te jete i bazuar ne web
- q) Të përfshijë mirëmbajtjen e programit të fiskalizimit për 12 muaj.
- r) Afati i implementimit bashke me integrimin me Sistemin Flare Billing 5 dite nga lidhja e kontrates.

Sipas vendimit nr:239 dt. 20/03/2020 bazuar në LIGJIN Nr. 87/2019 PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT;

Operatori Ekonomik duhet të ketë zgjidhjen e certifikuar të software-it në formën e një aplikacioni individual, ose një sistemi kompjuterik të integruar, ose një aplikacion Cloud, i cili mundëson:

- k) krijimin e një fature, një fature shoqëruese dhe vendosjen e të gjithë elementeve të nevojshëm;
- l) vlefshmërinë e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese;
- m) dërgimin e sigurt të të dhënave në sistemin qendror, duke përdorur certifikatën elektronike;
- n) lëshimin dhe pranimin e faturave elektronike;
- o) transmetimin automatik të të dhënave në administratën tatimore dhe marrjen e mesazhit konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të secilës faturë individuale ose fature shoqëruese;
- p) ruajtjen e të dhënave të faturave ose të faturave shoqëruese;
- q) gjenerimin e numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLFSH) dhe numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH);
- r) gjenerimin e kodit QR;
- s) printimin e faturës ose thjesht kodit QR, në situata të përcaktuara në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”;
- t) sigurojnë shkëmbimin e të dhënave në kohë reale dhe me autentifikim të sigurt të pajisjeve fiskale ekzistuese ose sistemit të fiskalizimit;

sipas Ligjit Nr. 2/2017 PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Funksionalitetet të tjera që duhet të ketë programi:

1. Bazat e të dhënave, të jenë të paaksesueshme jashtë këtij sistemi
2. Hyrja në program të sigurohet me kredenciale “përdorues” dhe “Fjalëkalim”.
3. Të ofrojë një mekanizëm për administrimin e privilegjeve në mënyrë të detajuar për funksionalitete të ndryshme. Në këtë mënyrë çdo përdorues ka akses vetëm tek ambientet, modulet apo raportet që i janë përcaktuar më parë nga një përdorues administrator.
4. Të ofroje mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara.
5. Të ofroje mundësinë që një përdorues i caktuar të mund të shikojë vetëm veprimet e tij dhe jo veprimet e të tjerëve.
6. Të mundesojë regjistrimin e çdo krijimi, anulimi apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve.

7. Të mundesoje regjistrimin e datës, orës, përdoruesit dhe të IP-së së atij që ka kryer veprimin gjatë regjistrimit të auditimit.
8. Të mundesoje historikun e veprimeve, pra të mund të shihen dokumentet si kanë qenë para modifikimit.
9. Backup. Të dhënat të ruhen çdo ditë nëpërmjet një procesi automatik backup.

Shpërndarja: SHRUKD

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: SHRUKD

III.4.4. Nga shqyrtimi i procesverbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim” të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin Elektronik të Prokurimit konstatohet, se autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë: **“2.4.1 Operatori ekonomik duhet të ketë Autorizim Prodhuesi ose distributori për Programin e Faturim – Arketimi Flare Billing që disponon Autoriteti kontraktues. Kjo të vertetohet nëpërmjet paraqitjes së Autorizimit të leshuar nga një kompani e licencuar nga autoritetet perkatese shtetërore. Kjo kompani të jete vete prodhuesi i sistemit ose të jete e autorizuar nga prodhuesi i sistemit për të leshuar atë lloj Autorizimi.**

**Argumentim:** Duke qenë se AK përdor sistemin Flare Billing, për të shmangur çdo incident gjatë periudhës së integritimit të dy sistemeve dhe kryerjes së procesit të fiskalizimit, kerkohet që kompania të vertetojë që mund të punoj me sistemin Flare Billing.

Sistemi duhet të jete COTS (Commercial off-the-shelf). Ky sistem nuk duhet të ketë kosto licencash për instalime në ambient test, ambient zhvillimi dhe për shtimin e përdoruesve. Për të vertetuar këtë kusht ofertuesit duhet të paraqesin:

- a. Autorizimi i Prodhuesit për implementim, mirembajtje dhe zhvillim i cili të specifikojë projektin, datën, adresën e qartë të prodhuesit dhe të bashkëngjijë certifikatën e regjistrimit të sistemit.
- b. deklaratën nga prodhuesi i sistemit ku përcaktohet qartë menyrën e licencimit të sistemit që kerkohet të implementohet.
- c. deklaratë nga prodhuesi që sistemi/moduli është i integruar me modulet e tjera sic kerkohet në specifikimet teknike duke i përmendur saktë emrat e sistemeve apo moduleve me të cilat është i integruar dhe duke përcaktuar qartë menyrën dhe informacionin që është i integruar.

**Argumentim:** Që të sigurohet aftësia për implementimin e sistemit dhe bazuar në proceset e punës kritike, rëndësishme të shërbimeve që sistemi ofron kerkohet që OE të ofrojë një sistem i cili është i gatshëm dhe vetëm do të implementohet”.

III.4.5. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “Nexia AL Consulting” ShPK, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes nr. 36/25 prot., datë 05.02.2024 drejtuar ankimuesit, ka argumentuar si në vijim: **“Për sa i përket kësaj pike të ankesës theksojmë që sistemi i faturimit që AK ka në përdorim është mjaft i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punës dhe është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me arkëtimin që AK e ka mjaft të nevojshëm. Me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor kërkon të forcojë besimin dhe sigurinë që operatori ekonomik i interesuar do të ofrojë shërbimin sipas të gjithë kërkesave të paraqitura në specifikimet teknike në pikën “b” dhe “i”. Gjithashtu, autoriteti nëpërmjet këtij autorizimi garanton që të gjithë të dhënat historike janë të sigurta gjatë këtij procesi**

*integrimi i cili është shumë kritik dhe garanton rikthimin e tyre në gjendjen fillestare në rast të çdo anomalie apo në rast mos funksioni. Nga sa më sipër KSHA arsyeton se ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE nuk merret në konsideratë”.*

III.4.6. Në nenin 2 ‘Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- i) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- j) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- k) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- l) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

6. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

7. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: “2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si

*dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.4.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik lidhur me aftësinë për disponimin e një sistemi COST. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim, duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës, me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, në respekt të nenit 2 të LPP-së. Lidhur me pretendimin e mësipërm të ankimuesit, për sa i përket heqjes së kërkesës për pikën 2.4.1 *Autorizim Prodhuesi ose distributori për Programin e Faturim – Arkëtimi Flare Billing që disponon Autoriteti kontraktues. Kjo të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së Autorizimit të lëshuar nga një kompani e licencuar nga autoritetet përkatëse shtetërore. Kjo kompani të jetë vetë prodhuesi i sistemit ose të jetë e autorizuar nga prodhuesi i sistemit për të lëshuar atë lloj Autorizimi*, si dhe të kërkesës së autoritetit kontraktor lidhur me mënyrën e integritetit të sistemit të fiskalizimit që kërkohet të implementohet me modulet e tjera, (tek termat e referencës) konkretisht me Programin e Faturim – Arketimi Flare, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në kriterin kualifikues të pikës 2.4.1 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, nuk është në përputhje me objektin e kontratës e cila është *“Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore”*, pasi qëllimi, të cilin enti prokurues e ka vendosur për këtë kriter kualifikues arrihet nëpërmjet mbikqyrjes së kontratës nëpërmjet pranimi të shërbimit, sipas specifikimeve teknike të vendosura në Shtojcën 5 të këtyre dokumenteve dhe është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, pranimi i shërbimit të kontraktorit në përputhje me këto specifikime, prandaj autoriteti kontraktor duhet që të modifikojë dokumentet e tenderit, duke e hequr kriterin kualifikues të pikës 2.4.1. të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendosi:**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Nexia AL Consulting” SHPK, për procedurën e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar- shërbime” me Nr. REF-93973-01-24-2024, me objekt “Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirëmbajtje vjetore” me fond limit 3,996,000 (Tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sh.A
  2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nexia AL Consulting” SHPK për modifikim të dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
  3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
  4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Nexia AL Consulting” SHPK.
  6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

